



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 9613 Prot.

Vlorë, më 19.06. 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ datë ____ 2024

**“PËR MIRATIMIN E SHESHIT “DETARËT SHQIPËTAR” DHE VENDOSJEN E
MEMORIALIT ME SIMBOLET E DETARISË NË TERRITORIN E BASHKISË
VLORË”**


Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 8, neni 9.1, pika 1.1/a dhe b, pika 1.7/b, neni 54 pika II; me propozim të shoqatës atdhetare-kulturore “Detaria Shqipëtare” datë 14.02.2023 të miratuar nga Komisioni Këshillimor për Titujt VENDORË të Nderit të Këshillit të Bashkisë datë 03.06.2024, në shkresën e Prefektit të Qarkut Vlorë nr. 1055/1 Prot, datë 19.12.2023 duke vlerësuar historinë dhe traditën detare që nga lashtësia të qytetit Vlorë si dhe në relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë së bashku me dokumentacionin shoqërues, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës 27.06.2024

VENDOSI:

1. Të miratojë emërtimin e sheshit “Detarët Shqiptarë” në lagjen Pavarësia, pranë Muzeut Pavarësia, në territorin e Ballinës Urbane sipas planvendosjes së përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës bashkëlidhur këtij vendimi si dhe vendosjen në këtë shesh të memorialit me simbolet e Detarisë.
2. Për zbatimin e këtij Projektvendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6

KRYETAR
Ermat Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 9613 Prot.

Vlorë, më 19.06. 2024

RELACION

MBI PROJEKTVENDIMIN

**“PËR MIRATIMIN E SHESHIT “DETARËT SHQIPËTARË” DHE VENDOSJEN E
MEMORIALIT ME SIMBOLET E DETARISË NË TERRITORIN E BASHKISË
VLORË”**

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Vlorë

Ju paraqesim për miratim projektvendimin “Për Miratimin e Sheshit “Detarët Shqipëtarë” dhe Vendosjen e Memorialit me Simbolet e Detarisë në Territorin e Bashkisë Vlorë” i cili është një propozim i shoqatës atdhetare-kulturore “Detaria Shqiptare”.

Ky propozim është kërkuar të vlerësohet nga Këshilli i Bashkisë edhe prej Prefektit të Qarkut Vlorë. Sikurësë është theksuar në propozimin e Shoqatës “Detaria Shqiptare”, qyteti i Vlorës është qytet bregdetar ku historia e traditat detare i kanë fillimet e tyre që nga lashtësia. Për rrjedhojë emërtimi i një sheshi dhe vendosja e një memoriali me simbolet e detarisë është një reflektim i historisë së këtij qyteti.

Nisur nga ky këndvështrim vlerësojmë se emërtimi i një sheshi me emrin “Detarët Shqiptarë” në lagjes Pavarësia, pranë Muzeut Pavarësia në territorin e Ballinës Urbane, si dhe vendosja e një memoriali me simbolet e detarisë është një vlerë e shtuar për qytetin tonë bregdetar dhe njëkohësisht në funksion të turizmit, destinacion kryesor i zhvillimit ekonomik të tij.




Ky propozim është miratuar edhe nga Komisioni Këshillimor i Titujve Vendorë të Nderit i Këshillit të Bashkisë në datën 03.06.2024, Komision i cili gjithashtu propozon që ky projektvendim të miratohet nga Këshilli i Bashkisë

Nga sa më lartë kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë të miratojë këtë projektvendim, në kushtet që shoqata “Detaria Shqiptare” është e gatshme për të bashkëpunuar në funksion të realizimit të memorialit të propozuar.

Ju faleminderit

KRYETAR
Ermal Dredha





BASHKIA VLORE

DREJTORIA E
URBANISTIKËS

MIRATOI
KLAUDIO MEHMETAJ

VENDODHJA

PËR MIRATIMIN E SHESHIT "DETARËT SHQIPËTAR" DHE VENDOSJEN E MEMORIALIT ME SIMBOLET E DETARISË NË TERRITORIN E BASHKISË VLORE

VLORE 2024

A-01